



14 nëntor 2014, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA
Komuna e Mamushës shkel Ligjin për Buxhet

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe ka hulumtuar çështjen e pagesës së pagave të mësimdhënësve dhe mjekëve të caktuar, por edhe të punonjësve të administratës komunale nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve të buxhetit komunal të Mamushës.

Në bazë të dokumenteve që janë siguruar nga komuna e Mamushës, figuron se Kryetari i Komunës së Mamushës ka marrë një morri vendimesh, nga muaji shkurt e deri në korrik të 2014-ës, për pagesën e pagave të kontratës mbi vepër të një mësimdhënësi në shkollën “Anadolu” dhe dy mjekëve specialistë të Qendrës së Mjekësisë Familjare, si dhe të dy zyrtarëve të administratës komunale, me mjete nga kategoria buxhetore e dedikuar për mallra dhe shërbime. Në të njëjtën kohë praktika e ngjashme është zbatuar edhe në vitin 2013, në disa raste.

Në lidhje me këtë çështje, monitoruesit e EC Ma Ndryshe i kanë drejtuar Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Administratës Publike kërkesën për sqarime ligjore, nëse ekzekutimi i pagave nga kategoria buxhetore e mallrave dhe shërbimeve është e lejuar me ligjet në fuqi.

Sqarimi i marrë nga zyrtarët e Ministrisë së Financave ka sugjeruar se një gjë e tillë përbën shkelje të Ligjit për Buxhetin 2014. MF po ashtu ka sugjeruar që të kihet parasysh edhe mundësia e angazhimeve të përkohshme që krijohen nga marrëdhënia e punës me shërbime të veçanta, sipas dispozitave të Ligjit të Punës.

Ligji Nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 në nenin 10 që përkufizon Limitet në Zotime dhe Shpenzime, në paragrafin 6 thekson se “shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të mëditjeve apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat dhe dhuratat”.

Ndërsa Ligji Nr. 03/L-212 i Punës në nenin 10, paragrafi 6, thekson se “Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë brenda një 1 viti”, gjë që nuk është përfillur nga Komuna e Mamushës.

EC Ma Ndryshe duke i marrë për bazë këto të gjetura rekomandon Komunën e Mamushës që:

- Të përmirësoj planifikimin e buxhetit vjetor komunal;
- Të ndër marr masa të menjëhershme që praktikën e pagesës së mësimdhënësve, mjekëve dhe punëtorëve të administratës të mos realizohen më nga kategoria mallra dhe shërbime, por nga kategoria e dedikuar për pagat, duke i futur të gjithë punonjësit në sistemin e pagave;

- Të respektojë limitet e caktuara mbi numrin e punëtorëve në administratën komunale; dhe
- Të menaxhoj me ndjeshmëri më të madhe paranë publike.

Gjithashtu, EC Ma Ndryshe rekomandon MAPL-në që të mbikëqyr në mënyrë më strikte vendimet e Komunës së Mamushës, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me ligjet në fuqi.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.